



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA THEMELORE PRISHTINE - DEGA E GJYKATËS FUSHË KOSOVE

Numri i lëndës: 2022:158485

Datë: 03.01.2024

Numri i dokumentit: 05246236

K.nr.3538/22

Gjykata Themelore Prishtinë-Dega Fushë Kosovë: Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni i Kundërvajtjes: Gjyqtarja Misare Murturi Hoxha duke vendosur në procedurën kundërvajtëse kundër të pandehurit “TRANSULTRAOIL” sh.p.k, me numër unik të identifikimit të biznesit 811421320 me adresë në fshatin Miradi e Epërme – Fushë Kosovë me Drejtor për njësinë në Miradi të Epërme, Erdinc Agush, sipas kërkesës e Inspektoratit të Tregut – Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, për shkak të kundërvajtjes nga neni 6 të Ligjit Nr.08/L-018 Për tregtinë me produkte të naftës dhe karburanteve të ripërtëritshme, pas përfundimit të shqyrtimit gjyqësor, me datë 05.12.2023, merr këtë:

A K T G J Y K I M

I pandehuri:

“TRANSULTRAOIL sh.p.k” me numër unik të identifikimit të biznesit 811421320 me adresë në fshatin Miradi e Epërme – Fushë Kosovë, me Drejtor për njësinë në Miradi të Epërme, Erdinc Agush, dhe menaxher Blerim Hyseni.

ËSHTË PËRGJEGJËS

Sepse,

Ka ushtruar veprimtari tregtare – mbajtje në deponi të lëndëve djegëse, dizel dhe benzine, pa Leje të Importit, Deponim dhe shitje me shumicë për Dizel dhe Benzinë, duke shkaktuar kundërvajtje për shkak të veprimit këssoj në kundërshtim me nenin 6 par.2 të Ligjit Nr.08/L-018 për tregtinë me produkte të naftës dhe karburanteve të ripërtëritshme, ku përcaktohet se "të gjitha subjektet që merren më veprimtari të produkteve të naftës ose karburanteve të ripërtëritshme, duhen të pajisen me leje të vlefshme", në lidhje me nenin 19 par. 4 të të njëjtit ligj.

Kjo sepse gjatë inspektimit të pandehuri, në datë 14.07.2022, është konstatuar se i pandehuri në mungesë të licencës përkatëse i ka pasur të deponuara në stoqe 62,296 litra dizel dhe 19,786 litra benzinë.

-Me këtë i pandehuri ka kryer kundërvajtje nga neni 6 të Ligjit Nr.08/L-018 Për tregtinë me produkte të naftës dhe karburanteve të ripërtëritshme.

Gjykata, në mbështetje të nenit 2, 7, 8, 9, 13, 27, 28, 29, 30, 35, 48, 77 dhe 127 të Ligjit Nr. 05/L-087 për Kundërvajtje, të pandehurit i shqipton:

DËNIM ME GJOBË

- I.** Dënim me gjobë në lartësi prej 16,000 € (gjashtëmbëdhjetë mijë euro), të cilin dënim është i obliguar që ta paguajë brenda afatit prej 15 ditëve nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e arkëtimit me detyrim.
- II.** Obligohet i pandehuri që në emër të paushallit gjyqësor t'i paguan kësaj gjykate shumën prej 5 € (pesë euro), në afatin prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e arkëtimit me detyrim.

Arsyetim

Inspektorati i Tregut – MINT me datë 04.08.2022 ka dorëzuar në Gjykatë kërkesën 4671-19/2022, për fillimin e procedurës kundërvajtëse ndaj të pandehurit "TRANSULTRA OIL sh.p.k" me numër unik të identifikimit të biznesit 811421320 me adresë në fshatin Miradi e Epërme – Fushë Kosovë me Drejtor për njësinë në Miradi të Epërme Erdinc Agush, për shkak

të kundërvajtjes neni 6 të Ligjit Nr.08/L-018 Për tregtinë me produkte të naftës dhe karburanteve të ripërtëritshme.

Gjykata, pasi mori në dorëzim kërkesën e lartcekur, konstatoi se ekzistojnë kushtet e mjaftueshme për fillimin e procedurës së kundërvajtëse.

Në seancën e mbajtur me datë 30.10.2023 ku i pandehuri u përfaqësua nga i pandehurit Blerim Hyseni, i njehti deklaroi se në ditën e inspektimit me datë 14.07.2022, inspektorët kishin qenë për inspektim të rregullt mujor të cilësisë së karburanteve dhe të njëjtëve u janë prezantuar shitjet dhe blerjet deri në datën 08.07.2022 kur kishte skaduar afati i licencës të cilën e jep MINT, dhe sipas të njëjtit nda data e skadimit të licencës OE “Transultraoil” nuk ka realizuar asnjë shitje apo blerje të naftës dhe produkteve të saj.

Deklaroi poashtu se paraprakisht kishte aplikuar për licencën, para skadimit të së njëjtës sikurse edhe kërkohet sipas ligjit, duke i prezantuar Gjykatës një dokument kërkesë për ripërtëritje të licencës data e të cilës nuk shihet qartë dhe mban emrin Kërkesë për leje: Deponim të dizelit dhe benzinës, duke pohuar se pas këtij aplikimi edhe janë pajisur me licencë, me datë 24.11.2022 nga MINT për shitje me shumice të dizelit dhe benzinës dhe për import dhe deponim të dizelit dhe benzinës e cila skadon me 23.11.2028. Shtoi se me rastin e vizitës së inspektorëve të AKT dhe MINT, ai të njëjtit i njoftoi se licenca u kishte skaduar dhe se janë në pritje të licencës së re, dhe se ashtu siç ishin udhëzuar nga inspektorët brenda 8 ditëve nga dita e inspektimit i njehti ka shkuar në zyrë të inspektorit në MINT, ku i ka njoftuar lidhur me gjendjen, përkatësisht procedurën në zhvillim për pajisje me licencën e re, për marrjen e së cilës deklaroi se ka pasur vonesa për arsyes e Ministria e Ambientit ka kërkuar kontrate afatgjate të qirasë prej 6 vite e dy muaj dhe u ka marrë kohë derisa e kanë siguruar një kontratë të tillë, ndërsa që gjatë periudhës sa nuk kanë pasur licencë nuk kanë operuar fare, nuk kanë tregtuar me naftë, benzinë dhe produkte të tyre, por kanë filluar të punojnë vetëm pas sigurimit të licencës së re. Në gjykatë kanë dorëzuar pasqyrat e katër llogarive bankare të OE “Transultraoil” sh.p.k. për të cilat kanë pretenduar se janë të vetmet përmes të cilave i pandehuri afaron në ushtrimin e veprimtarisë së vet, dhe me pretendimin se nga transaksionit, pozicionit e hyrje-daljeve monetare në të njëjtat shihet se gjatë periudhës sa ky operator ekonomik nuk ka pasur licencë pune, i njehti operator, këtu i pandehur edhe nuk ka afaruar.

Në seancën e radhës të caktuar dhe mbajtur nga Gjykata në këtë çështje kundërvajtëse, me datë 27.11.2023, inspektori Labinot Ahmeti nga Administrata Tatimore e Kosovës (ATK) i cili ka qenë në inspektim te i pandehuri me datë 14.07.2022 bashkë me inspektoren Fexhrije Salihu nga MINT, kur është konstatuar se OE pandehuri ka punuar edhe pas skadimit të licencës, ka njoftuar Gjykatën se në bazë të se në bazë të udhëzimit administrativ i cili kishte hyrë në fuqi me nr. 03/2022 për rregullimin e çmimeve të produkteve të naftës dhe karburanteve të ripërtëritshme me masave të tjera mbrojtëse, inspektorët e MINT dhe ATK inspektojnë bashkërisht në terren te operatorët ekonomik të cilët merren me shitblerjen dhe deponimin e naftës, ndërsa si detyrë e tij si inspektor nga ATK ka qenë vlerësimin se a i respektojnë operatorët ekonomik kufinj të çmimeve tavan të përcaktuara me udhëzimin në fjalë, dhe se çështja se a ka pasur licencë apo jo i pandehuri nuk hyn në kuadër të fushë veprimtarisë së tij për inspektim, dhe se me atë pjesë është marrë inspektorja nga MINT.

Në seancën e datës 29.11.2023 është dëgjuar nga Gjykata Fexhrije Salihu, inspektore nga MINT e cila ka qenë në inspektim te i pandehuri, e cila deklaroi se te i pandehuri kanë shkuar bashkë me inspektorin e ATK-së me datën 14.07.2022 për të parë nëse i njëjti po punonte sipas çmimeve të lejuara me udhëzimin administrativ nr. 03/2022 dhe gate inspektimit të kryer është konstatuar me procesverbalin nr. 00513 se i pandehuri, përkundër mos pasjes së licencës valide për import, deponim dhe shitje dhe shitje me shumicë për benzinë dhe dizel, i njëjti u ka prezantuar inspektorëve se i ka pasur të deponuara në stoqe: 62,296 litra dizel dhe 19,786 litra, e që në mungesë të licencës, ku vetë i pandehuri e ka pranuar se nuk është në posedim të licencës së vlefshme, nuk guxon ti ketë në deponi për shkak licenca e punës në këto raste është edhe për deponim të dizelit dhe benzinës, dhe pa licencë të vlefshme nuk është i lejuar të ketë të deponuar as edhe një litër të këtyre lëndëve të rrezikshme, për shkak të rrezikut që paraqesin produktet e naftës, dhe se me rastin e vizitës dhe pas prezantimit nga menaxheri i operatorit ekonomik se i kanë të deponuara sasinë e përmendura të lëndëve djegëse, pa pasur licencë për një gjë të tillë, të njëjtit i është kërkuar që brenda tetë ditëve të prezantoj në MINT dokumentacionin përkatës të ushtrimit të veprimtarisë tregtare me derivatet e naftës dhe benzinës, dhe se edhe përkundër afatit të dhënë ligjor, i pandehuri, nuk ka arritur të prezantoj licencën për import deponim dhe shite me shumicë për benzine dhe dizel brenda afatit 8 ditor, çka konfirmon se i pandehuri i ka pasur të deponuara sasinë respektive të dizelit dhe benzinës pa pasur licencë për ketë gjë.

Pas dëgjimit të përfaqësuesit të të pandehurit, dhe të inspektorëve dhe pas vlerësimit të provave në këtë çështje kundërvajtëse: Procesverbal nr. 00513 i datës 14.07.2022, stoku i derivateve të naftës i datës 14.07.2022, Aplikimi për Leje të Importit për Dizel dhe Benzinë me numër protokolli 421, të datës 09.11.2022, Aplikimi për Leje të Importit për Dizel dhe Benzinë me numër protokolli 419, të datës 09.11.2022, Lejen e Import dhe deponim të Dizel dhe Benzinë të vlefshme prej datës 24.11.2022 deri me datë 23.11.2028, Aplikimi i lejes së shitjes më shumicë për Dizel dhe Benzinë me numër protokolli 420 të datës 09.11.2022, Lejen e shitjes me shumicë të Dizel dhe Benzinë të vlefshme prej datës 24.11.2022, Policën e sigurimit për deponinë e derivateve të naftës prej datës 24.11.2022 deri me datë 23.11.2028, Gjykata vërtetoi se i pandehuri është përgjegjës, për kundërvajtjen e kryer ngase me datë 14.07.2022, ka pasur të deponuara në stoqe 62,296 litra dizel dhe 19,786 litra benzinë, përkundër faktit që siç e pranon edhe vetë nuk ka pasur licencë të vlefshme, në këtë rast, për deponim të dizelit dhe benzinës, dhe licencë pune në përgjithësi.

Prandaj, marrë parasysh rrezikshmërinë që mbartin në vete këto substanca – lëndë djegëse të deponuara për ambientin dhe rrethin në përgjithësi, dhe të mbajtura në mungesë licence e cila pas vlerësimit të parametrave përkatës, të sigurisë në radhë të parë, siguron masat dhe kushtet e sigurta për deponimin e këtyre substancave, Gjykata pas vërtetimit të gjendjes faktike si në kërkesën për fillimin e procedurës kundërvajtëse ndaj të pandehurit, dhe duke marrë për bazë rrethanat e parapara me nenin 31 të Ligjit mbi Kundërvajtje, peshën e veprës kundërvajtëse, pasojat, rrezikshmërinë shoqërore, shkallën e përgjegjësisë së të pandehurit, të njëjtin e gjeti përgjegjës dhe e dënoi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, me bindje se edhe me këtë dënim do të arrihet efekti pozitiv i sanksionimit dhe se në të ardhmen do të shmanget nga kryerja e veprave të këtilla apo të ngjashme.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës është marrë në bazë të nenit 59 të Ligjit për Kundërvajtje.

Me sa u cekë më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjykata Themelore Prishtinë-Dega Fushë Kosovë
Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni i Kundërvajtjes

K.nr.3538/22, datë 05.12.2023



Gjyqtarja

Misare Murturi Hoxha

Këshillë juridike: Kundër këtij aktgjykimi pala e autorizuar ka të drejtë ankese në afat prej 8 ditësh, nga dita e pranimi të aktgjykimit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, e nëpërmjet kësaj Gjykate.